



Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBETARE PER INTEGRIMIN EUROPIAN

Grupi i Punës për Kapitullin 24 – Bashkëpunimi Polici–Media: Liria e Shprehjes dhe Siguria Publike në Procesin e Integrimit Evropian

10 qershor 2026, 11:00 – 12:30

Rekomandime

Tryeza e Kapitullit 24 – Drejtësia, Liria, Siguria, e organizuar nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në bashkëpunim me **Policinë e Shtetit** në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Evropian, më **10 qershor 2026**, u fokusua në bashkëpunimin ndërmjet Policisë së Shtetit dhe medias, si një fushë ku ndërthuren standardet e të drejtave të njeriut me kërkesat për siguri publike, ruajtjen e rendit dhe mbrojtjen e gazetarëve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Praktika europiane në këtë fushë ka ndjekur qasje të ndryshme për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet policisë dhe medias, veçanërisht gjatë demonstratave dhe ngjarjeve të tjera publike. Duke u mbështetur në këto praktika, propozohet shqyrtimi i rekomandimeve të mëposhtme:

1. Një element i rëndësishëm është garantimi i një dallimi të qartë ndërmjet rolit të policisë dhe atij të gazetarëve gjatë protestave dhe tubimeve publike. Gazetarët duhet të trajtohen sipas standardeve specifike që njohin funksionin e tyre në informimin e publikut dhe që garantojnë sigurinë e tyre gjatë raportimit në terren. Në këtë kuadër, është e nevojshme që ata të mos konsiderohen pjesë e turmës apo e aktorëve të protestës, por të kenë mundësinë të ushtrojnë detyrën e tyre në mënyrë të pavarur dhe të sigurt.
2. Në praktikë hasen një sërë çështjesh që kërkojnë qartësi më të madhe institucionale. Për shembull, në rastet kur gjatë protestave ndodhin incidente që prekin gazetarët, si dëmtimi i pajisjeve profesionale, ndërhyrjet që pengojnë transmetimet live apo dëmtimi i automjeteve të mediave gjatë raportimit, është e rëndësishme të bëhet e

*Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).

ditur nëse këto raste janë trajtuar në rrugë administrative apo penale dhe nëse procedurat përkatëse janë përmbyllur. Në rastet kur proceset nuk kanë përfunduar, lind nevoja për mekanizma të qartë ankimi dhe monitorimi, në mënyrë që çdo rast të trajtohet deri në fund dhe të mos mbetet pa adresim institucional.

3. Raste të tjera që kërkojnë vëmendje përfshijnë menaxhimin e pranisë së automjeteve të transmetimit të drejtpërdrejtë gjatë protestave dhe tubimeve publike, si dhe pozicionimin e tyre në zona të sigurta, me qëllim shmangien e ekspozimit të gazetarëve dhe ekipeve teknike ndaj rreziqeve të panevojshme ose përfshirjes në zonat me nivel më të lartë tensioni. Po aq e rëndësishme është garantimi që masat e sigurisë të mos shndërrohen në pengesa për ushtrimin e lirë të veprimtarisë mediatike dhe raportimin e pavarur në terren. Në këtë kuadër, bëhet i domosdoshëm forcimi i mekanizmave të mbrojtjes së gazetarëve dhe i procedurave të reagimit institucional.

4. Në këtë kontekst, masat parandaluese duhet të merren përpara zhvillimit të demonstratave dhe ngjarjeve publike. Kjo kërkon informim të ndërsjellë, komunikim të vazhdueshëm dhe koordinim ndërmjet Policisë së Shtetit, gazetarëve dhe organizatave mediatike, me qëllim garantimin e një raportimi të lirë dhe të sigurt në terren.

5. Përtej garantimit të mbrojtjes së gazetarëve gjatë protestave dhe tubimeve publike, krijimin e perimetrave mbrojtës për të shmangur ekspozimin e tyre ndaj rrezikut dhe sulmeve nga grupe të ndryshme, nevojitet zhvillimi i kapaciteteve institucionale për trajtimin e kërcënimeve që vijnë përmes platformave online. Në këtë kuadër, është e rëndësishme të vlerësohet nëse udhëzueset apo protokollet ekzistuese të Policisë së Shtetit adresojnë në mënyrë të mjaftueshme sigurinë e gazetarëve si në terren, ashtu edhe në mjedisin dixhital. Mungesa e adresimit të sigurisë së gazetarëve në mjedisin dixhital përbën një boshllëk që kërkon ndërhyrje të mëtejshme institucionale.

6. Punonjësit e policisë të angazhuar në operacionet për ruajtjen e rendit publik duhet të marrin trajnim praktik mbi identifikimin e gazetarëve, respektimin e rolit të tyre gjatë demonstratave, komunikimin e përshtatshëm me përfaqësuesit e medias dhe zbatimin e standardeve europiane në situata reale operationale. Trajnimet duhet të përfshijnë gjithashtu ushtrime praktike dhe simulime, duke përfshirë gazetarët sa herë që kjo është e mundur.

7. Njëkohësisht, edhe gazetarët kanë nevojë për trajnime të vazhdueshme mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë raportimit nga demonstratat dhe ngjarjet publike, procedurat e bashkëveprimit me strukturat e rendit, vlerësimin e rrezikut dhe masat e

*Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritetit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).

sigurisë fizike dhe dixhitale. Zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta ndërmjet policisë dhe përfaqësuesve të medias do të kontribuonte në përmirësimin e bashkëpunimit në terren. Në këtë kuadër, Gjermania ka investuar në trajnime të specializuara për sigurinë e gazetarëve që raportojnë në ngjarje me nivel të lartë rreziku.

8. Vlerësohet ngritja dhe funksionimi i mekanizmave të komunikimit publik në Policinë e Shtetit, përmes emërimit të një koordinatori për të drejtën e informimit dhe të zëdhënësve pranë Drejtorive Vendore të Policisë në qarqe, por rekomandimet e mësipërme evidentojnë nevojën për krijimin e mekanizmave të përhershëm të ndërlidhjes ndërmjet policisë dhe medias. Një mekanizëm i tillë, që do të përfshinte Policinë e Shtetit, prokurorinë, shoqatat e gazetarëve dhe organizatat mediatike, do të krijonte hapësira të rregullta dialogu dhe bashkëpunimi përpara se të ndodhin incidente konkrete. Struktura të ngjashme funksionojnë tashmë me sukses në disa vende europiane dhe kanë kontribuar në rritjen e forcimit të besimit institucional dhe përmirësimin e efektivitetit operacional. Në këtë drejtim, Suedia ka zhvilluar modelin e saj të dialogut, duke vendosur theks te komunikimi përpara, gjatë dhe pas zhvillimit të demonstratave. Holanda ka krijuar PersVeilig, një partneritet gjithëpërfshirës që bashkon gazetarët, policinë dhe prokurorinë për të mbështetur raportimin, ndjekjen e rasteve dhe ofrimin e asistencës për gazetarët që përballen me kërcënime. Ndërkohë, Franca, Kroacia dhe Irlanda kanë përcaktuar gjithashtu oficerë ndërlidhës, mekanizma raportimi dhe kanale të strukturuar komunikimi ndërmjet autoriteteve dhe medias.

9. Zgjedhjet vendore të vitit 2027 përbëjnë një mundësi të rëndësishme për të testuar në praktikë funksionimin e mekanizmave të mbrojtjes së gazetarëve në kushte reale operacionale. Për këtë arsye, përgatitjet duhet të nisin në një fazë të hershme, duke i kushtuar vëmendje të veçantë zonave jashtë Tiranës, ku gazetarët lokalë dhe rajonalë shpesh kanë më pak mundësi ndërveprimi me institucionet qendrore. Periudha para zgjedhore mund të shfrytëzohet për organizimin e sesioneve informuese në të gjithë vendin, promovimin e pikave të kontaktit të Policisë së Shtetit, shpërndarjen e materialeve praktike mbi të drejtat e gazetarëve dhe mekanizmat ekzistues të mbrojtjes, si dhe për zhvillimin e ushtrimeve të përbashkëta simuluese me pjesëmarrjen e policisë, prokurorisë dhe përfaqësuesve të medias. Njëkohësisht, është e rëndësishme të hartohen tregues të qartë vlerësimi, të cilët do të mundësojnë monitorimin dhe matjen e efektivitetit të zbatimit të këtyre mekanizmave gjatë gjithë periudhës zgjedhore.

*Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).